

Krijimi i vendeve të punës, prioritet për Kosovën

IMF Survey

25 janar 2016

- FMN-ja rishikoi programin ekonomik të Kosovës dhe disbursoi 35.1 milionë euro shtesë
- Ekonomia po shënon progres por ende mbesin sfida
- Ende duhen reforma për rritje dhe krijim të vendeve të punës

Ekonomia e Kosovës po rimëkëmbet falë progresit të konsiderueshëm në zbatimin e reformave ekonomike, por ajo duhet ta nxisë rritjen potenciale dhe të krijojë më shumë vende pune, posaçërisht tek të rinjtë, theksoi FMN-ja pas rishikimit të parë të aranzhimit të kredisë të cilën Kosova e ka siguruar nga FMN-ja vitin e kaluar.

Duke folur për *IMF Survey*, Shefi i Misionit të FMN-së për Kosovën, Jacques Miniane, si dhe Përfaqësuesi Rezident i FMN-së në Kosovë, Ruud Vermeulen, theksuan se është shënuar përparim i konsiderueshëm, por se ekonomia ende përballet me sfida thelbësore, duke përfshirë përmirësimin e aftësisë së saj konkurruese. FMN është duke e mbështetur programin ekonomik të autoriteteve përmes Marrëveshjes [Stand-By](#).

IMF Survey: Na tregoni pak më shumë për ekonominë e Kosovës, karakteristikat e saj kryesore si dhe sfidat më të mëdha.

Miniane: Kosova është një shtet i ri, që ka shpallur zyrtarisht pavarësinë më 2008. Në pasqyrim të kësaj, Kosova ka popullatën më të re në Evropë, ku gjysma e kosovarëve janë nën moshën 25 vjeçe. Kjo është edhe vlera kryesore e ekonomisë, por edhe sfida e saj më e madhe.

Pse sfida? Sepse, përderisa ekonomia ka shënuar rritje të qëndrueshme me normë mesatare prej rreth 3 për qind, gjë që nuk është dobët krahasuar me fqinjët e saj të Ballkanit Perëndimor, ajo duhet të rritet shumë më shpejt se kaq në mënyrë që të ardhurat të jenë të barasvlershme me ato të standardeve të Evropës Lindore, si dhe për të siguruar vende pune për të rinjtë që i bashkohen fuqisë punëtore. Aktualisht, të ardhurat për kokë banori janë rreth 3.000 €, gjersa papunësia është shumë e lartë, në nivel prej 30 për qind. As autoritetet as ne nuk mund të jemi të kënaqur me rezultate të tilla dhe të gjithë jemi shumë të vetëdijshëm për sfidat e mëdha konkurruese me të cilat përballet vendi.

IMF Survey: Në korrik të vitit 2015, FMN-ja aprovoi Marrëveshjen Stand-By për Kosovën. Çfarë ishte ajo që nxiti autoritetet të kërkojnë program dhe cilat parime kanë formësuar strukturën e programit?

Vermeulen: Në muajt para zgjedhjeve të vitit 2014 ka pasur zgjerim të konsiderueshëm në shpenzimet publike, si për shembull rritje të mëdha të pagave në sektorin publik dhe pensioneve sociale, si dhe pakoja e beneficioneve për veteranët e luftës. Kjo nuk ishte e qëndrueshme. Autoritetet u kthyen tek FMN-ja për ta rivendosur kredibilitetin dhe për të marrë mbështetje në reformat e vështira politike.

Filozofia prapa strukturës së këtij programi është e thjeshtë: realizoni vetëm disa gjëra të rëndësishme, por përpiquni që ato t'i realizoni mirë. Çfarë do të thotë kjo? Për shembull, nga ana fiskale, të mos ketë konsolidim vetëm për hir të konsolidimit. Në fakt, deficitin mund të ngrihet në kuadër të programit, por kryesorja është që kjo hapësirë të shfrytëzohet për investime kritike të infrastrukturës, apo për shpenzime sociale të synuara mirë të cilat vërtetë ndihmojnë personat më të cenueshëm. Ngjashëm, aspektet e programit për reforma strukturore dhe financiare janë mjaft dorështrënguara. Ne po përpiqemi të synojmë një grup të kufizuar çështjesh të cilat i konsiderojmë si të rëndësishme, siç janë kostot jokonkurrese të fuqisë së punës, korrupsioni dhe sundimi i ligjit, si dhe pengesat për ndërmjetësim financiar.

IMF Survey: A mund ta përshkruani progresin e arritur që nga aprovimi i programit?

Miniane: Kosova ka shënuar progres. Deri më tani, të gjitha objektivat e reformës fiskale dhe strukturore janë përmbushur, disa prej tyre madje përpara afatit. Kjo është dëshmi e përkushtimit të fuqishëm të autoriteteve dhe pronësisë së programit. Situata fiskale është duke u përmirësuar falë përpjekjeve për t'i mobilizuar të hyrat dhe frenuar shpenzimet joproduktive. Të dhënat preliminare për vitin 2015 sugjerojnë se deficitin fiskal është edhe nën objektivat e programit dhe brenda kufijve të rregullave fiskale.

Reformat në sektorin financiar gjithashtu janë duke vazhduar me ritëm solid. Banka qendrore ka futur një kornizë të re për asistencë të likuiditetit emergjent në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare, që është kyçe për një ekonomi të euroizuar. Në të njëjtën kohë, Banka Qendrore po ndërmerr hapa për ta forcuar më tutje aftësinë e saj për t'i monitoruar dhe vlerësuar rreziqet në sistemin bankar.

Së fundi, po shohim progres në anën strukturore. Qasja në kredi pritët të përmirësohet falë heqjes së pengesave për huadhënie bankare, siç janë dobësitë në zbatimin e kontratave. Përveç kësaj, zëvendësimi gradual i prokurimit të decentralizuar me atë të centralizuar, dhe pastaj aplikimi i prokurimit elektronik, veçse janë duke rezultuar në kursime të matshme. Kjo është dëshmi e faktit që prokurimi publik është duke u bërë gjithnjë e më i barabartë dhe transparent dhe është shembull konkret se si mund të arrihet përparim kundër korrupsionit ekonomik. Përkundër kësaj, ne nuk jemi naivë dhe jemi të vetëdijshëm se ende ka shumë për t'u bërë.

IMF Survey: Cilat janë rreziqet kryesore të programit?

Vermeulen: Rreziku kryesor është qartas nga ana politike. Ngërçi aktual politik ndikon në besimin e konsumatorëve dhe investitorëve dhe mund t'i largojë investitorët nga projekte të rëndësishme, siç janë ndërtimi i termocentralit të ri dhe qendrës skitare të klasit botëror. Kjo do të kishte ndikim negativ në rritje, krijim të vendeve të punës dhe mbledhje të të hyrave, dhe kështu do t'i rrezikonte objektivat e programit. Paraliza parlamentare gjithashtu mund të vonojë miratimin e ligjeve të rëndësishme. Përfundimisht, nuk mund të shpërfillet rreziku që palët nuk do të arrijnë të gjejnë zgjidhje, e cila në anën tjetër do të rrezikonte zhbërjen e shumë prej arritjeve në kuadër të programit.

IMF Survey: A mund të na tregoni pak për reformën në pagat publike? Pse është e nevojshme kjo?

Miniane: Që nga pavarësia në vitin 2008, ciklet e zgjedhjeve kanë koïnciduar me rritje shumë të mëdha të pagave të sektorit publik, ku qeveria është dukshëm burimi më i madh i punësimit në Kosovë. Si rezultat i kësaj, pagat e sektorit publik pothuajse janë trefishuar në terma nominalë, janë rritur tri herë më shpejt se BPV nominale; dhe kanë tejkaluar ndjeshëm pagat publike në vendet fqinje, pagat e sektorit privat në Kosovë, si dhe rritjen e produktivitetit. Kjo nuk është situatë e qëndrueshme. Rritja e hendekut midis pagave të sektorit publik dhe atij privat e bën më të vështirë që sektori privat të tërheqë dhe mbajë talentin, ndërkohë që rritja e kostove të punës ka dëmtuar aftësinë konkurruese të Kosovës.

Që një ekonomi si Kosova ta rifitojë aftësinë e saj konkurruese dhe të krijojë vende pune, është kritike që të ulen shpenzimet reale të punës. Programi synon përmbyshjen e këtij objektivit përmes ngrirjes së pagave nominale të sektorit publik për disa vite, si dhe aplikimin e një rregulli për pagat publike përmes së cilit rritja e pagave do të kufizohet me rritjen e BPV-së nominale në të ardhmen. Kuvendi e ka miratuar këtë rregull, dhe ai do të hyjë në fuqi më 2018. Jemi të inkurajuar me pronësinë e fortë e këtyre masave nga ana e autoriteteve dhe presim që ato do ta stabilizojnë pagën publike në rreth 9 për qind të BPV-së, që është në nivel të arsyeshëm.

IMF Survey: Si e vlerësoni aftësinë konkurruese të ekonomisë?

Vermeulen: Aftësia e përgjithshme konkurruese është e ulët. Siç u la të kuptohet më parë, kostot e punës janë shumë të larta duke pasur parasysh nivelet aktuale të produktivitetit. Kjo është kryesisht për shkak të remitancave të cilat kanë rritur pagën rezervë, bashkë me rritjen e papërmbytur të pagave të sektorit publik. Në tërësi, kemi vlerësuar se norma real efektive e këmbimit është e mbivlerësuar me rreth 15-20 për qind, ndoshta edhe më shumë.

Për më tepër, konkurrueshmëria në aspektet e tjera që nuk lidhen me çmimin është cenuar si pasojë e hendekut të infrastrukturës dhe shkathtësive, pengesave në kreditë bankare dhe dobësive në mjedisin e biznesit dhe sundimit të ligjit. Megjithatë, jemi të sigurt se konkurrenca e Kosovës dhe pozita e jashtme e saj do të përmirësohen përmes disa prej masave të përfshira në program të cilat ulin koston e punës, krijojnë hapësira për investime në infrastrukturë, dhe forcojnë zbatimin e kontratave dhe procesin e prokurimit publik. Megjithatë, do të duhet kohë për t'i rregulluar çështjet e konkurrencës të rrënjosura thellë.

IMF Survey: Çfarë mund të na thoni për ndikimin ekonomik të krizës aktuale të refugjatëve?

Miniane: Deri më tani kriza e refugjatëve pasur ndikim të kufizuar në Kosovë. Shumica e refugjatëve e kanë anashkaluar Kosovën në rrugëtimin e tyre për në Evropën Perëndimore. Megjithatë, Kosova ka një diasporë të konsiderueshme në vendet si Gjermania dhe Zvicra dhe një numër i konsiderueshëm personash kanë emigruar para jo shumë kohësh, duke arritur nivelet e pas konfliktit të 1990-ta në fillim të vitit 2015.

Kriza e refugjatëve mund të nënkuptojë që vendet pritëse do të pranojnë më pak emigrantë nga Kosova. Gjermania tashmë e ka shpallur Kosovën si vend të sigurt të origjinës dhe tani po i kthen azilkërkesit në shtëpi. Kështu, elementi i sigurisë sociale të emigracionit që zbuste ndikimin e papunësisë së lartë mund të jetë në rrezik. Përderisa këto rreziqe, por dhe rreziqet e tjera të lidhura nuk mund të injorohen, ne nuk presim që kjo do të ketë ndikim material në remitancat nga diaspora tashmë e konsoliduar në Evropën Perëndimore.

IMF Survey: Me sy drejt së ardhmes, cilat janë prioritetet më të ngutshme ekonomike për Kosovën?

Vermeulen: Më lejoni t'i vë gjërat në perspektivë: çdo i treti kosovar i moshës së punës është i papunë, dhe çdo i dyti i moshës rinore. Në këtë kontekst, ngritja e perspektivës së rritjes afatmesme dhe krijimi i vendeve të punës mbetet prioriteti numër një për vendin. Për këtë qëllim, Kosova duhet të lëvizë nga modeli i saj aktual i rritjes së nxitur nga remitancat drejt një modeli që nxitet nga prodhimi dhe eksportet. Përveç kësaj, Kosova duhet t'i mbyll hendeqet e saj të konkurrencës për t'i zhbllokuar investimet në sektorët e eksportit, të financuara nga brenda dhe jashtë.

Si pjesë e kësaj, është me rëndësi kritike që të luftohet më me forcë korrupsioni endemik dhe të forcohet sundimi i ligjit. Përderisa politikat në kuadër të programit përpiqen t'i trajtojnë këto probleme, do të duhen shumë vite për ta trajtuar rrënjën e këtyre çështjeve. Programi aktual skadon në maj të vitit të ardhshëm, prandaj dhe do të jetë e rëndësishme që të vazhdohen përpjekjet e reformës fiskale, financiare dhe strukturore përtej horizontit kohor të programit.